



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET**

Nr 6097/5 prot

Tiranë, më 24 / 10 / 2014

## **Udhëzim mbi Metodikat e Kontrollit Ekspres të Mallrave për Ndotje Radioaktive**

Varësisht faktit nëse mallrat futen në organizmin e njeriut (ushqimi, duhani, etj) ose kanë kontakt direkt me trupin e tij (mallrat kozmetike, larëse, etj), apo janë pjesë të mjedisit ku ai jeton (si hekuri i ndërtimit, materiale ndërtimi, skrapi metalik, etj), ne i kemi ndarë në dy grupe metodikat e kontrollit të mallrave të import - eksportit për ndotje radioaktive.

Meqenëse grupi i parë i mallrave është burim ekspozimesh të brendshme ndaj rrezatimeve radioaktive, duhet patjetër që ndotjet e futura prej tyre në organizmin njerëzor të karakterizohen në terma aktiviteti specifik ( $Bq/kg$ ); kurse për grupin e dytë të tyre, për qëllime thjesht praktike, ato mund t'u referohen dhe kushteve mjedisore ku lindet, zhvillohet e jeton njeriu. Në metodikat e kësaj kategorie, ndotjet jepen si shumëfishe të fonit natyror të rrezatimit gamma mbi fonin lokal natyror.

### **1. Kontrolli për Ndotje Radioaktive i Mallrave Ushqimore me Kontakt Direkt me Trupin e Njeriut.**

#### **1.a. Metodika e Kontrollit në Mostra në Dhomë Plumbi**

(Matjet zhvillohen në të njëjtën gjeometri, me të cilën është bërë kalibrimi përkatës me metoda gamma spektrometrike.

Koeficienti i kalibrimit është  $K = 70 \text{ Bq} / \text{kg} \cdot \text{ips}$ ). Kalibrimi kryhet një herë në vit.

1. Ndizet aparatura matëse dhe lihet për 10 minuta që të ngrohet;
2. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rrezatimit gamma total pa e vendosur enën e marine lit në dhomën e plumbit. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
3. Llogaritet shpejtësia fonike mesatare e numërimit të rrezatimit gamma total, pa enë marine li në detektorin e rrezatimeve.
4. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rrezatimit gamma total duke vendosur mbi detektorin e rrezatimeve në dhomën e plumbit enën e marine lit të marinelit. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
5. Llogaritet shpejtësia fonike mesatare e numërimit të rrezatimit gamma total, me enë marine li boshe mbi detektorin e rrezatimeve.
6. Krahasohen mesataret e shpejtësive të numërimit të foneve, të llogaritura si më lart, për t'u siguruar që ena e marinelit nuk ka ndotje radioaktive dhe mund të vazhdohet me hapat e tjera.
7. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rrezatimit gamma total, duke vendosur mbi detektorin e rrezatimeve në dhomën e plumbit enën e marine lit të mbushur me ujë të rrjetit. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
8. Llogaritet shpejtësia mesatare e numërimit të fonit të rrezatimit gamma total, ( $F \text{ ips}$ ), me enë marineli të mbushur me ujë të rrjetit mbi detektorin e rrezatimeve. Ky është

- “Foni” që do të merret parasysh gjatë matjeve të rrezatimit gamma total të mostrës së mallit që kontrollohet.
9. Përgatitet mostra e mallit që kontollohet për ndotje radioaktive dhe futet në enën e marine lit (duke e copëtuar, grimcuar, bluar apo shkërmor). Paketimi i mostrës bëhet pak a shumë me të njëjtën shkallë ngjeshjeje si gjatë kalibrimit gamma spektrometrik të metodikës për pajisjen matëse-detektuese, që përdoret konkretisht.
  10. E vendosim enën e marine lit të mbushur me mostrën e mallit që kontollohet mbi detektorin e rrezatimeve në dhomën e plumbit dhe bëhen 10 lexime të shpejtësisë së numërimit të rrezatimit gamma total. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
  11. Llogaritet shpejtësia e numërimit të rrezatimit gamma total, me enë marineli, të mbushur me mostrën e mallit që kontollohet, mbi detektorin e rrezatimeve (N ips).
  12. Vlerësohet sinjifikanca e ndryshimit midis F dhe N, të përcaktuara si më lart;
  13. Në rast se ndryshimi është sinjifikativ, diferenca  $D = N - F$  transformohet në aktivitet specifik  $A_{sp}$  të Ceziunit total ( $^{134}\text{Cs} + ^{137}\text{Cs}$ ) në mostrën e kontrolluar, duke përdorur faktorin e kalibrimit,  $K = 70 \text{ Bq / kg* ips}$ , dhe relacionin  $A_{sp} = D*K$ .
  14. Aktiviteti specifik  $A_{sp}$  krahasohet me nivelet e lejuara të përbajtjes së Ceziunit total në mallra (të vendosura nga KMR) dhe, në varësi të destinacionit të mallit (për fëmijë apo të rritur) merret vendim për lejim të përdorimit të mallit, ose për blokim të tij për kontolle të mëtejshme me anë të metodave gamma spektrometrike në IFBZ.
  15. Bëhet certifikimi i mallit për përbajtje, ose mospërbajtje të ndotjeve radioaktive.

## **2. Metodika e Kontrollit për Ndotje Radioaktive të Mallrave të Magazinuara ose në Transporte.**

### **2. a. Kontrolli për Gjeometri $2\pi$ të Matjeve**

(Malli që do kontollohet ndodhet në mjetë transporti, si kamiona, trailerë, anije, etj. Zakonisht, matjet në këto raste kryhen në gjeometrinë  $2\pi$ . Koeficienti përkatës i kalibrimit është  $K = 2 \text{ Bq / kg*ips}$ ). Kalibrimi kryhet një herë në vit.

1. Ndizet aparatura matëse dhe lihet për 10 minuta që të ngrohet.
2. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rrezatimit gamma total, duke u larguar në një vend të hapët, të paktën 30-40 m larg objektit që do të kontollohet, dhe duke e mbajtur sondën detektuese të rrezatimit gamma afro 1 m mbi tokë, të montuar në krahun teleskopik ose në largësinë e krahut nga vetja, në rast se nuk ka të tillë. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
3. Llogaritet shpejtësia mesatare e numërimit të fonit të rrezatimit gamma total, ( $F$  ips), që do të merret parasysh në matjet e rrezatimit gamma total të mallit që kontollohet.
4. Llogaritet shpejtësia shtesë e numërimit mbi fonin natyror  $F_{\text{ëp}}$  të cilën kapet niveli maksimal i lejuar i aktivitetit specifik të “ndotjes” gamma totale:  $\Delta = A_{sp} / K$ , ku  $A_{sp}$  është aktiviteti specifik i lartpërmendur (sipas normave të miratuara nga KMR-ja).
5. Vendoset instrumenti matës në mënyrë të tillë që të japë alarm zanor kur arrihet vlera  $P = F + \Delta$  e shpejtësisë së numërimit.
6. Kontollohet transporti duke e mbajtur sondën detektuese 5 deri 10 cm larg sipërfaqes së mjetit transportues dhe duke bërë trajktore zik-zake nga pjesa më e lartë e tij deri në pjesën fundore të tij. Largësia mes profileve të kontrollit nuk duhet të jetë më shumë se 30 cm, kurse shpejtësia e lëvizjes së sondës detektuese nuk duhet të kalojë 30 cm / s.

7. Në pjesët e transportit ku aktivizohet alarmi, bëhen matje më të kujdeshme, duke i dendësuar profilet e kontrollit dhe duke ulur shpejtësinë e lëvizjes së sondës detektuese.
8. Në rastet kur zonat e dyshuara konfirmohen me ndotje radioaktive, kërkohet shkarkimi i mallit për ta kontrolluar në tjetër mjedis, në mënyrë që të verifikohet pastërtia radioaktive e vet mjetit të transportit.
9. Kontrollohen pjesët e sipërme dhe të poshtme të mjetit të transportit me anë të instrumentit të montuar në krahun teleskopik.
10. Aktiviteti specifik  $A_{sp}$  krasohet me nivelet e lejuara maksimale të përbajtjes së Ceziumit total në mallra (të vendosura nga KMR) dhe, në varësi të destinacionit të mallit (përdorim për fëmijë apo të rritur), merret vendim për lejim të përdorimit të mallit ose për bllokim të tij për kontolle të mëtejshme në laboratorin gamma spektrometrik të IFBZ.
11. Në rast se gjenden mallra me ndotje radioaktive të konfirmuar, njoftohet supervizori i shërbimit të kontrollit si dhe drejtuesi i institucionit dhe kërkohet nga ata mendim për hatap e mëtejshme të përgjigjes.
12. Në rast se ndotja radioaktive e mallit është lokale (e kufizuar), me kërkësë të pronarit të mallit mund të kalohet në bonifikimin e ngarkesës dhe veçimin e pjesës radioaktive të tij nga pjesa tjetër e pastër. Ky operacion duhet kryer në çdo rast me dijeni të drejtuese të institucionit dhe shërbimit dhe në koordinim me shërbimin e transportit të lëndëve radioaktive, dhe të trajtimit të mëtejshëm të tyre në impiantin e mbetjeve.
13. Bëhet çertifikimi i mallit për përbajtje ose mospërbajtje të ndotjeve radioaktive.

## **2. b. Kontrolli i Mallrave në Ballo dhe Stiva**

Malli që kontrollohet ndodhet i magazinuar në ballo ose stiva. Zakonisht matjet në këto raste kryhen në gjeometri  $2\pi$  ose më të vogla. Për rastin e parë, koeficienti i kalibrimit është  $K = 2 \text{ Bq} / \text{kg}^* \text{ips}$ . Kalibrimi kryhet një herë në vit.

Në varësi të paketimit të objektit të matur, koeficienti i kalibrimit ka këto vlera:

<u>Lloji i paketimit</u>	<u>Faktori i Kalibrimit</u>
Gjeometri $2\pi$	$2 \text{ Bq}/\text{kg}^* \text{ips}$
50 kg	$4 \text{ Bq}/\text{kg}^* \text{ips}$
25 kg	$4.5 \text{ Bq}/\text{kg}^* \text{ips}$
10 kg	$7.5 \text{ Bq}/\text{kg}^* \text{ips}$

1. Ndizet aparatura matëse dhe lihet për 10 minuta që të ngrohet.
2. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rrezatimit gamma total, duke u larguar në një vend të hapët, të paktën 30-40 m larg objektit që do të kontrollohet, dhe duke e mbajtur sondën detektuese të rrezatimit gamma rrëth 1 m mbi tokë, të montuar në krahun teleskopik, ose në largësi të krahut nga vetja, në rast se nuk ka të tillë. Intervali midis leximeve vendoset 10 sekonda.
3. Llogaritet shpejtësia mesatare e numërimit të fonit të rrezatimit gamma total, ( $F \text{ ips}$ ), e cila do të merret parasysh në matjet e rrezatimit gamma total të mallit që kontrollohet.
4. Llogaritet shpejtësia shtesë e numërimit  $\Delta$  mbi fonin natyror  $F_{\text{ëp}}$  të cilën kapet niveli maksimal i lejuar i aktivitetit specifik të "ndotjes" gamma totale  $A_{sp} / K$ , ku  $A_{sp}$  është aktiviteti specifik i lartpërmendur (sipas normave të miratuara nga KMR-ja).
5. Vendoset instrumenti matës në mënyrë të tillë që të japë alarm zanor kur arrihet vlera  $P = F + \Delta$  e shpejtësisë së numërimit.

6. Kontrollohet malli i paketuar duke e mbajtur sondën detektuese 5 deri 10 cm larg sipërfaqes së tij, duke bërë trajktore zik-zake nga pjesa më e lartë e stivës apo ballos deri në pjesën fundore të saj. Largësia mes profileve të kontrollit nuk duhet të kalojë 30 cm, kurse shpejtësia e lëvizjes së sondës detektuese nuk duhet të jetë mbi 30 cm/s.
7. Në pjesët e mallit ku aktivizohet alarmi i pajisjes, bëhen matje më të kujdeshme, me profile më të dendura kontrolli dhe shpejtësi më të ulët të zhvendosjes së sondës detektuese.
8. Aktiviteti specifik  $A_{sp}$  krahasohet me nivelet e lejuara maksimale të përmbajtjes së Ceziumit total në mallra (të vendosura nga KMR), dhe në varësi të destinacionit të mallit (përdorim për fëmijë apo të rritur), merret vendim për lejim të përdorimit të mallit, ose për bllokim të tij për kontolle të mëtejshme në laboratorin gamma spektrometrik të IFBZ.
9. Në rast se gjenden mallra me ndotje radioaktive të konfirmuar, njoftohet supervizori i shërbimit të kontrollit si dhe drejtuesi i institucionit dhe kërkohet nga ata mendim për hapat e mëtejshme të përgjigjes;
10. Në rast se ndotja radioaktive e mallit është lokale (e kufizuar), me kërkesë të pronarit të mallit mund të kalohet në bonifikimin e ngarkesës dhe veçimin e pjesës radioaktive të tij nga pjesa tjeter e pastër. Ky operacion duhet kryer në çdo rast me dijeni të drejtuesve të institucionit dhe shërbimit dhe në koordinim me shërbimin e transportit të lëndëve radioactive, dhe të trajtimit të mëtejshëm të tyre në impiantin e mbetjeve.
11. Bëhet certifikimi i mallit për përmbajtje, ose mospërmbajtje të ndotjeve radioaktive.

### **3. Kontrolli për Ndotje Radioaktive i Mallrave Joushqimore (skrapi metalike, materiale ndërtimi, etj.)**

1. Ndizet aparatura matëse dhe lihet për 10 minuta që të ngrohet.
2. Bëhen 10 lexime të fonit natyror të rezatimit gamma total, duke u larguar në një vend të hapët, të paktën 30-40 m larg objektit që do të kontrollohet, dhe duke e mbajtur sondën detektuese të rezatimit gamma afro 1 m mbi tokë, të montuar në krahun teleskopik, ose në largësinë e krahut nga vetja, në rast se nuk ka të tillë. Intervalli midis leximeve vendoset 10 sekonda.
3. Llogaritet shpejtësia mesatare e numërimit të fonit të rezatimit gamma total, ( $F_{ips}$ ), që do të merret parasysh në matjet e rezatimit gamma total të mallit që kontrollohet.
4. Llogaritet shpejtësia e numërimit, dy shpejtësi fonike të numërimit mbi fonin lokal të rezatimit gamma.
5. Vendoset instrumenti matës që të japë alarm zanor për vlerën ( $3^*F$ ) të shpejtësisë së numërimit.
6. Kontrollohet materiali duke e mbajtur sondën detektuese 5 deri 10 cm nga sipërfaqja e tij, duke bërë trajktore zik-zake nga pjesa më e lartë e transportit (grumbullit) deri në pjesën fundore të tij. Largësia midis profileve të kontrollit nuk duhet të jetë më shumë se 30 cm, kurse shpejtësia e lëvizjes së sondës detektuese nuk duhet të kalojë 30 cm/s;
7. Në pjesët e mallit ku aktivizohet alarmi i pajisjes, zhvillohen matje më të kujdeshme, me profile më të dendura kontrolli dhe me shpejtësi më të vogël të zhvendosjes së sondës detektuese.
8. Në rast se gjenden mallra me ndotje radioaktive të konfirmuar, njoftohet supervizori i shërbimit të kontrollit si dhe drejtuesi i institucionit dhe kërkohet nga ata mendim për hapat e mëtejshme të përgjigjes.

9. Në rast se ndotja radioaktive e mallit është lokale (e kufizuar), me kërkesë të pronarit të mallit mund të kalohet në bonifikimin e ngarkesës dhe veçimin e pjesës radioaktive të tij nga pjesa tjeter e pastër. Ky operacion duhet kryer në çdo rast me dijeni të drejtuese të institucionit dhe shërbimit dhe në koordinim me shërbimin e transportit të lëndëve radioaktive dhe të trajtimit të mëtejshëm të tyre në impiantin e mbetjeve.
10. Bëhet certifikimi i mallit për përmbajtje ose mospërmbajtje të ndotjeve radioaktive.

---

SEKRETA RI  
Rustem PA CI

---

KRYETARI  
Ilir BEQAJ